

M^o 1840 Prot.

STATUT

oll. 14.04.2026

I SHOQËRISË AKSIONARE “ALBANIAN DIGITAL SOLUTION” SH.A.

Sot me datë 14/04 / 2026, në Tiranë, në cilësinë e Aksionarit të vetëm, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, z. Igli Tafa, i datëlindjes 16.06.1979, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal H90616170I, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 43/2023 "Për Qeverisjen Elektronike" i ndryshuar, bie dakord të miratoj statutin e shoqërisë aksionare, "ALBANIAN DIGITAL SOLUTION" SH.A.

KREU I

EMËRTIMI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1

Forma dhe emërtimi i shoqërisë

1. Shoqëria është person juridik shqiptar, që ka formën ligjore të shoqërisë aksionare me ofertë private, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar (këtu e në vijim "Ligji për shoqëritë tregtare"), si dhe ligjit nr. 43/2023 "Për Qeverisjen Elektronike", i ndryshuar.
2. Emri i Shoqërisë është "ALBANIAN DIGITAL SOLUTION" SH.A.
3. Shoqëria lejohet të përdorë në aktivitetin e përditshëm emërtimin tregtar, sa vijon: "ADS" SH.A
4. Aksionari i vetëm i shoqërisë është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm.
5. Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi dhe nga ky statut.

Neni 2

Selia e shoqërisë, stema dhe vula

1. Selia e shoqërisë "ALBANIAN DIGITAL SOLUTION" SH.A. ndodhet në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II", nr. 3, 1001, Tiranë, Shqipëri.
2. Shoqëria mund të hapë dhe të mbyllë zyra dhe degë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
3. Shoqëria ka stemën dhe vulën e saj, të cilat miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar.

KREU II

QËLLIMI DHE OBJEKTI I SHOQËRISË

Neni 4

Qëllimi i shoqërisë

1. Qëllimi i Shoqërisë është të sigurojë zhvillimin, operimin, mirëmbajtjen, mbështetjen teknike dhe mbrojtjen e sistemeve, platformave dhe infrastrukturave digjitale publike, si edhe ofrimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe të sigurisë kibernetike për institucionet publike dhe subjektet private, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me synim garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve, rritjen e qëndrueshmërisë së infrastrukturave të informacionit dhe përmirësimin e cilësisë së sistemeve dhe shërbimeve.

Neni 5

Objekti i shoqërisë

1. Për qëllim të ushtrimit të veprimtarisë, Shoqëria kryen aktivitetet si më poshtë vijon:
 - a. zhvillimin, operimin, mirëmbajtjen dhe mbështetjen teknike të sistemeve, platformave dhe shërbimeve digjitale;
 - b. administrimin dhe menaxhimin e infrastrukturave të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK);
 - c. ofrimin e shërbimeve të sigurisë kibernetike, përfshirë parandalimin, monitorimin dhe reagimin ndaj incidenteve, testeve të qëndrueshmërisë së sistemeve, auditimeve të sigurisë.
 - d. integrimin dhe sigurimin e ndërveprueshmërisë së sistemeve dhe platformave shtetërore;
 - e. mbështetjen e transformimit digjital në institucionet publike;
 - f. zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve digjitale për institucionet publike dhe subjektet private;
 - g. bashkëpunimin me subjekte publike dhe private, vendas dhe të huaj, në funksion të realizimit të veprimtarisë së saj;
 - h. çdo veprimtari tjetër të lidhur me fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe sigurisë kibernetike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Shoqëria aksionare ofron shërbime të tjera shtesë të lejuara nga legjislacioni në fuqi për subjekte publike dhe private, në përputhje me qëllimin e krijimit dhe fushën e veprimtarisë së saj.
3. Shoqëria mund të kryejë aktivitete/veprimtari për studimin, projektimin, këshillimin e konsultimin për aktivitetet e përcaktuara në shkronjat a - h, të pikës 1.
4. Shoqëria, brenda kufijve që parashikon legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të reja, si dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.
5. Për përmbushjen e veprimtarisë së saj, Shoqëria mund të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë brenda dhe jashtë Shqipërisë.

KREU III
KAPITALI THEMELTAR - AKSIONET

Neni 6

Kapitali themeltar i Shoqërisë

1. Kapitali i Shoqërisë është 100% shtetëror.
2. Kapitali themeltar i shoqërisë është 700 000 000 (Shtatëqind milionë) lekë, që përbëhet nga 1000 (një mijë) aksione të zakonshme, me vlerë nominale 700 000 (shtatëqind mijë) lekë secili.
3. Aksionari i vetëm i 100% të aksioneve të shoqërisë është shteti shqiptar, i përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.
4. Kapitali themeltar transferohet me Vendim të Këshillit të Ministrave nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit tek “ALBANIAN DIGITAL SOLUTION” SH.A., pas regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
5. Aksionet janë të formës nominale dhe lirisht të transferueshme.

Neni 7

Zmadhimi i kapitalit

1. Zmadhimi i kapitalit realizohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.
2. Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet me derdhje në para ose me kontribute në natyrë, nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja ose nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese. Në çdo rast, kontributet shoqërohen me një certifikatë për nënshkrimin e tyre ose një raport vlerësimi, të kryer nga një ekspert i vlerësimit të kontributeve në natyrë.
3. Kapitali themeltar transferohet me Vendim të Këshillit të Ministrave nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit tek “ALBANIAN DIGITAL SOLUTION” SH.A., pas regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 8

Zvogëlimi i kapitalit

1. Asambleja e Përgjithshme vendos për zvogëlimin e kapitalit, sipas këtij statuti.

Neni 9

Transferimi i aksioneve

1. Aksionet janë të formës nominale dhe lirisht të transferueshme, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.
2. Aksionet dhe të drejtat e fituara si rezultat i transferimit të aksioneve nuk mund të ushtrohen kundrejt shoqërisë apo palëve të treta, përpara se ky transferim të regjistrohet në regjistrin e aksioneve.



Neni 10

Akti i emetimit të aksioneve

1. Aksionet e Shoqërisë emetohen mbi bazën e Aktit të Emetimit, i cili miratohet nga Administratori në lidhje me pjesën e realizuar.
2. Aksionet e reja nuk mund të emetohen përpara hyrjes në fuqi të zmadhimit dhe miratimit të Aktit të Emetimit.
3. Akti i Emetimit duhet të përmbajë të dhënat e kërkuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

Neni 11

Regjistri i aksioneve

1. Administratori mban regjistrin e aksioneve, me qëllim pasqyrimin e çdo të drejte të aksionarëve apo palëve të treta mbi aksionet e Shoqërisë ("Regjistri i Aksioneve").
2. Regjistri i Aksioneve duhet të përmbajë të dhënat e kërkuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.
3. Pronësia mbi aksionet dhe çdo e drejtë e lidhur me to, nuk mund të ushtrohet kundrejt Shoqërisë apo palëve të treta, përpara regjistrimit të kësaj pronësie në Regjistrin e Aksioneve të mbajtur nga Shoqëria.
4. Aksionari i vetëm pajiset me ekstraktin e Regjistrin të Aksioneve.
5. Administratori duhet të raportojë, brenda afateve të kërkuara, çdo ndryshim të të dhënave të regjistruara në Regjistrin e Aksioneve të Shoqërisë, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

KREU IV ORGANET E SHOQËRISË

Neni 12

Organet drejtuese të shoqërisë

1. Shoqëria organizohet sipas sistemit të drejtimit me dy nivele.
2. Organet e shoqërisë janë:
 - a) Asambleja e Përgjithshme;
 - b) Këshilli Mbikëqyrës dhe,
 - c) Administratori.

Neni 13

Asambleja e Përgjithshme

1. Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Aksionari i vetëm i Shoqërisë.
2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet, si më poshtë vijon:
 - a) përcaktimin dhe miratimin e politikave të përgjithshme tregtare
 - b) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, si dhe miratimin e skemës së shpërblimeve për këta anëtarë;
 - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorit; si dhe miratimin e skemës së shpërblimit për të,



- ç) emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, audituesit ligjorë dhe të likuiduesve, si dhe miratimin e skemës së shpërblimeve të tyre;
- d) miratimin e pasqyrave financiare vjetore, të llogarive, si dhe të raportit të ecurisë së veprimtarisë;
- dh) ndryshimin e Statutit;
- e) miratimin e blerjes, pjesëtimit apo anulimit të aksioneve;
- ë) miratimin e rritjes ose zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë;
- f) miratimin e transformimit, riorganizimit dhe likuidimit të Shoqërisë;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj
- gj) miratimin e shpërndarjes së fitimeve vjetore, si dhe të mbulimit të humbjeve;
- h) miratimin mbi pjesëmarrjen e Shoqërisë në kapitalin e shoqërive të tjera;
- i) miratimin mbi lëshimin e titujve të borxhit;
- j) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- k) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj administratorit;
- l) miratimin e strukturave ad hoc, ose subjekteve që ushtrojnë kontrollin e ligjshmërisë së veprimtarisë së shoqërisë për llogari të tij;
- ll) kërkimin e raporteve në kuadër të llogaridhënies nga organet e shoqërisë për çështje specifike, ose lidhur me ecurinë e përgjithshme të shoqërisë;
- m) krijimin e strukturave të posaçme të shoqërisë, për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni në fuqi;
- n) miratimin e strukturës organizative të shoqërisë
- nj) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statuti.

3. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Administratori kryen regjistrimin e vendimeve.

4. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
- c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- ç) vendimet për investime;
- d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

5. Nëse administratori nuk përmbush detyrimin për regjistrimin e vendimit brenda afatit të përcaktuar në këtë statut, Aksionari i vetëm urdhëron një punonjës tjetër të shoqërisë për të kryer regjistrimin pa vonesë.

Neni 14

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Mbledhja e Asamblesë mund të thirret nga Këshilli Mbikëqyrës, Administratori, ose nga Aksionari.
2. Të gjitha njoftimet për thirrjen e Mbledhjeve të Asamblesë kryhen sipas parashikimeve të Legjislacionit të Zbatueshëm, përmes njoftimit të dërguar me letër rekomande (postë të gjurmueshme) dhe njëkohësisht të dërguar me faks ose korrespondencë elektronike (e-mail), me

kërkesë konfirmimi, 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Njoftimi i Mbledhjes duhet të përmbajë orën, vendin, rendin e ditës, vendimet e propozuara me materialin mbështetës përkatës, si dhe kërkesat për kuorumin e nevojshëm për mbledhjen e propozuar.

3. Mbledhja e Asamblesë thirret detyrimisht një herë në vit dhe jo më vonë se fundi i 6-mujorit të parë pas mbylljes së vitit financiar.

4. Mbledhjet e Asamblesë mbahen në selinë e Shoqërisë, ose virtualisht nëpërmjet mjeteve telefonike/elektronike ose në çdo vend tjetër të propozuar dhe të dakordësuar nga Aksionari i vetëm.

5. Mbledhjet e Asamblesë mund të zhvillohen me anë të konferencave telefonike, platformave video ose mjeteve të ngjashme të komunikimit për aq kohë sa të gjithë Personat pjesëmarrës në mbledhje konfirmojnë komunikimin efikas në mbledhje. Pjesëmarrja në Mbledhjen e Asamblesë nëpërmjet këtyre mjeteve do të konsiderohet si prani fizike në këto mbledhje.

Neni 15

Këshilli Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme.

2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë individë, të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë, administratorët e shoqërive të tjera të të njëjtit grup, si dhe personat e lidhur me personat e mësipërm. Çdo emërim, i bërë në kundërshtim me këto parashikime apo me kriteret e ligjit, është absolutisht i pavlefshëm. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës detyrohen të informojnë menjëherë shoqërinë për çdo konflikt interesi, ose papajtueshmëri, sipas këtij neni.

3. Këshilli Mbikëqyrës do të ketë në përbërje të tij gjithnjë jo më pak se 6 (gjashtë) anëtarë, të cilët plotësojnë të gjitha kriteret e këtij neni.

4. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen për një periudhë 3-vjeçare. Afati i emërimit mund të rinovohet dhe ata mund të shkarkohen në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme sipas legjislacionit në fuqi

5. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë individë të cilët nuk mund të jenë në marrëdhënie pune me shoqërinë.

6. Nëse një ose disa vende të Këshillit Mbikëqyrës mbeten bosh për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqjeje, zëvendësimi i tyre duhet të kryhet jo më vonë se 3 muaj.

7. Një person nuk mund të emërohet si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë nëse:

a) është anëtar i Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës edhe në dy shoqëri të tjera të themeluara në Republikën e Shqipërisë;

b) është administrator në shoqërinë kontrolluese të Shoqërisë, ose në një shoqëri të kontrolluar nga Shoqëria;

c) është administrator në një shoqëri, e cila në të njëjtën kohë ka si administrator ose anëtar të Këshillit Mbikëqyrës, një anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë.

Neni 16

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një, i cili ngarkohen të mbledhin këshillin dhe të drejtojnë diskutimet. Ai emërohen për të gjithë kohën e mandatit të tyre në Këshillin Mbikëqyrës dhe është e rizgjedhshim.
2. Këshilli Mbikëqyrës mund të emërojë një sekretar.
3. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës dhe sekretari, paguhen sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 17

Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës mbledhet të paktën 4 (katër) herë në vit, gjatë sezonit të mbylljes së ushtrimit financiar, dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë, me thirrjen e Kryetarit ose Administratorit.
2. Kryetari duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, kur Administratori ose 1/3 (një e treta) e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim.
3. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët kërkues mund të thërrasin Këshillin, duke i përcaktuar rendin e ditës.
4. Si rregull, njoftimi duhet të bëhet të paktën 7 (shtatë) ditë pune përpara, me letër, ose çdo komunikim elektronik të besueshëm, por thirrja mund të jetë e vlefshme edhe verbalisht dhe pa afat, në qoftë se anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës e pranojnë atë.
5. Çdo thirrje duhet të tregojë çështjet kryesore të rendit të ditës.
6. Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës zhvillohet në selinë e shoqërisë, ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrje ose të pranuar nga këshilli.
7. Këshilli Mbikëqyrës mund të marrë një vendim të vlefshëm, në qoftë se janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij.
8. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Në rast votash të barabarta, ajo e Kryetarit është përcaktuese.
9. Këshilli Mbikëqyrës mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhjet e tij, i cili nënshkruhet nga anëtarët e Këshillit të pranishëm në mbledhje.
10. Zhvillimi i mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës regjistrohet në një procesverbal të hartuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, i cili nënshkruhet nga Kryetari. Procesverbali përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara dhe vendimet e marra. Parregullsitë për mbajtjen e procesverbalit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të marra. Secili anëtar ka të drejtë të marrë një kopje të procesverbalit.
11. Kopje të këtyre procesverbaleve vërtetohen nga Kryetari.

Neni 18

Mbledhjet me Mjete Elektronike

1. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mund të zhvillohen nëpërmjet tele-konferencave, video-platformave ose mënyrave të ngjashme të komunikimit elektronik, për sa kohë që të gjithë Personat që marrin pjesë në këtë mbledhje mund ta konfirmojnë diskutimin efektiv me njëri-tjetrin. Pjesëmarrja në një Mbledhje Këshilli që zhvillohet nëpërmjet tele-konferencës, video-platformës

ose mënyrave të ngjashme të komunikimit elektronik, në përputhje me fjalinë pararendëse, do të konsiderohet si prani fizike e Anëtarit në atë mbledhje.

2. Në çdo rast, rregullat e përcaktuara në këtë Statut për kuorumin e pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes së Këshillit Mbikëqyrës, zbatohen edhe për Mbledhjet e zhvilluara me Mjete Elektronike.

Neni 19

Kuorumi dhe Votimi

1. Në funksion të vlefshmërisë së Mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës, kuorumi i nevojshëm është pjesëmarrja e të gjithë anëtarëve të Këshillit në rast se Këshilli ka vetëm 3 (tre) anëtarë, dhe më shumë se gjysmën e anëtarëve të tij, në rast se Këshilli ka më shumë se 3 (tre) anëtarë, nëse nuk arrihet kuorumi, mbledhja do të shtyhet maksimumi deri në 3 (tre) ditë kalendarike.

2. Në funksion të vlefshmërisë së Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës, kuorumi i nevojshëm është votimi nga më shumë se gjysma e anëtarëve në Këshill, por në çdo rast për çështje që ka barazim votash, vota e kryetarit të Këshillit është përcaktuese.

3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës gëzojnë të drejtën për të shprehur votën me shkresë, me telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik, me përjashtim të rasteve kur një anëtar i Këshillit ka kundërshtime për këtë mënyrë vendimmarrjeje.

4. Një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës në rastet e parashikuara në pikën 3 të nenit 162, të Ligjit Nr. 9901/2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

5. Votimi do të koordinohet nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës (ose mbajtësi i procesverbalit në emër të tij), i cili do t'ua paraqesë Anëtarëve rezultatet e votimit pa vonesa të paarsyeshme por në çdo rast jo më vonë se 5 (pesë) ditë kalendarike.

Neni 20

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës, në cilësinë e organit mbikëqyrës, mbikëqyr vënien në zbatim të politikave tregtare të Shoqërisë dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin. Ai ka kompetencat e mëposhtme:

a) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;

b) të përgatisë, me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;

c) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;

ç) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;

d) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;

dh) të japë rekomandime dhe të miratojë strategjinë e Shoqërisë, përfshirë planin shumëvjeçar tregtar dhe të investimeve (si dhe programin ekonomiko-financiar) përpara se të paraqiten para Asamblesë së Përgjithshme për miratimin përfundimtar;

e) të sigurojë që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga Administratori. Këto dokumente duhet të miratohen nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për t'u paraqitur para Aksionarit të vetëm, së bashku me një raport të Këshillit Mbikëqyrës mbi sa më sipër, ku përmbahet edhe një opinion mbi raportin e ekspertëve kontabël, si dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

f) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur, e raporti i auditimit, drejtuar Asamblesë së Përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës. Raporti i Këshillit Mbikëqyrës, sipas shkronjës "f" më sipër, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;

g) të miratojë angazhimet për krijimin e detyrimeve të reja financiare, përpara se këto të paraqiten tek Aksionari i vetëm për miratimin përfundimtar;

gj) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;

h) të krijojë, nëse është e nevojshme, komitete të brendshme, të përbëra nga anëtarët e tij, me qëllim një ndarje efikase të detyrave;

i) të miratojë Rregulloren e Këshillit Mbikëqyrës;

j) të miratojë akte dhe metodologji të propozuara nga administratori në lidhje me përcaktimin e tarifave të shërbimeve të shoqërisë, si dhe përcaktimin e shtesave mbi page për punonjësit e shoqërisë.

k) të krijojë bashkëpunime tregtare afatgjata dhe të propozojë politika për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;

l) t'i paraqesë te Aksionari i vetëm propozime dhe rekomandime, nëse janë kërkuar në lidhje me çështje që janë kompetencë vendimmarrëse të këtij të fundit;

ll) të emërojë Sekretarin e Këshillit Mbikëqyrës dhe të miratojë përshkrimin e punës së tij;

m) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

2. Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij.

3. Këshilli Mbikëqyrës verifikon dhe kontrollon pasqyrat financiare të shoqërisë, të cilat duhet të paraqiten brenda pesë muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar nga Administratori.

4. Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës duhet të njoftojë menjëherë Aksionarin e vetëm, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të priset ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme.

Neni 21

Administratori

1. Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i shoqërisë mund të riemërohet.

2. Administratori emërohet për një afat prej 3 vitesh me të drejtë ri-emërimi dhe mund të shkarkohet në çdo moment nga Asambleja e Përgjithshme.

3. Administratori i Shoqërisë ndalohet të punësohet si administrator, të mbajë një pozicion drejtues apo të jetë i punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me Shoqërinë.

4. Administratori ka tagra të plota për të vepruar në emër të shoqërisë, sipas përcaktimeve të statutit dhe legjisllacionit në fuqi. Ai ka të drejtë dhe detyrohet:

a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;

- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare me të tretët dhe të ketë rolin e punëdhënësit në marrëdhëniet e punës me punonjësit e shoqërisë;
 - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqet Këshillit Mbikëqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga Asambleja e Përgjithshme;
 - d) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) të raportojë përpara Këshillit Mbikëqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
 - e) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
 - f) të miratojë rregullore, udhëzime, manuale, procedura dhe akte të tjera të brendshme në kuadër të organizimit dhe funksionimit të shoqërisë.
 - g) të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
5. Detyrat që ligji i cakton Këshillit Mbikëqyrës nuk mund ti delegohen Administratorit.
6. Administratori mund tu delegojë, autorizojë brenda kompetencave të tij një ose disa punonjësve të shoqërisë, të drejtën për të kryer veprime apo kategori veprimesh.
7. Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, administratorët duhet të informojnë menjëherë kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 22

Audituesi Ligjor

1. Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga Audituesi/t ligjorë, të licencuar nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, të emëruar për një mandat 1 (një)-vjeçar, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Auditimi ligjor i Shoqërisë kryhet nga Audituesi/t ligjorë dhe/ose shoqëria e auditimit, sipas legjislacionit në fuqi, të emëruar për një mandat 1 (një)-vjeçar, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 23

Detyrimi për ruajtjen e sekretit

Administratori, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe çdo person tjetër që merr pjesë në mbledhjet e këtyre organeve duhet të ruajë fshehtësinë për çështjet dhe të dhënat që kanë karakter të brendshëm.

Neni 24

Parashikime të tjera

1. Ky statut ndryshohet ose zëvendësohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Personat, që janë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale, të parashikuara në Kreun III të pjesës së posaçme të Kodit Penal, për një afat deri në 5 vjet nga data e këtij dënimi, nuk mund të mbajnë funksionet e përfaqësuesit ligjor të një shoqërie tregtare, nuk mund të jenë anëtarë të këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës dhe as përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

3. Të gjitha mosmarrëveshjet gjatë funksionimit të shoqërisë zgjidhen me mirëkuptim ose i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar në fuqi.
4. Për çfarë nuk është shprehur në statut, referimi bëhet tek dispozitat e legjislacionit Shqiptar në fuqi për Shoqëritë Tregtare.
5. Ky statut hyn në fuqi me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme.
6. Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje të barasvlershme, në gjuhën shqipe.

AKSIONARI I VETËM THEMELUES

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Përfaqësuar nga

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Igli Tafa

